

 REPUBLIKA E KOSOVES (REPUBLIQUE A KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO) MINISTRIA E MIRENITETIT DHE TREGATISES (MINISTRE DITETIT DHE TREGATISES) MINISTRY OF ECONOMIC AFFAIRS AND TRADE	
Nr. shifraz Orgjeshkod Org. Code	DPANB
Nr. fageve Nr. Stranica No. Pages	/
Nr. Prot. Prot. No.	8649/24
Data Datume	31.12.24
PRISHTINE / A	
Na 1	

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 9 dhe Nenit 12, paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1, duke u bazuar në Nenin 34, paragrafin 2 dhe Nenin 39 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare Nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

KODIN E ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale përcakton parimet dhe rregullat bazë të sjelljes dhe etikës në ushtrimin e veprimtarisë profesionale të inxhinierëve, duke përmbushur kështu detyrimet e tyre ndaj publikut, klientëve, kolegëve të tyre dhe Odës.

Neni 2 Fushëveprimi

- Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për të gjithë inxhinierët e licencuar në Republikën e Kosovës nga Oda.
- Ky Kod zbatohet përshtatshmërisht edhe për anëtarët tjerë të Odës.

Neni 3 Përkufizimet

- Shprehjet e përdorura në këtë Kod kanë këto kuptime:
 - Inxhinier** – Inxhinier i licencuar nga Oda në përputhje me Ligjin në fuqi dhe rregulloren përkatëse;
 - Oda** – Oda e Inxhinierëve të Republikës të Kosovës
- Shprehjet tjera të përdorura kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).

3. Emrat në njërën gjini të përdorura në këtë Kod nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

Neni 4 **Përgjegjësia disiplinore**

Shkelja e Kodit nga inxhinieri apo anëtari tjetër i Odës rezulton në përgjegjësi disiplinore për të.

KAPITULLI II **DETYRIMET E INXHINIERIT TË LICENCUAR**

Neni 5 **Parimet themelore**

1. Inxhinieri mbështet dhe promovon integritetin, nderin dhe reputacionin e profesionit të inxhinierit duke:

- 1.1. zbatuar standardet më të larta të pavarësisë dhe paanësisë, fshehtësisë profesionale, integritetit, ekspertizës, profesionalizmit dhe cilësisë sa më të lartë të projekteve dhe shërbimeve të tjera me synimin e përmirësimit të vazhdueshëm;

- 1.2. kryer detyrat e profesionit me ndërgjegje dhe përgjegjësi në mënyrë profesionale, ligjore dhe etike;

- 1.3. zbatuar njohuritë dhe ekspertizën e tij për të ruajtur sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, mbrojtur mjedisin dhe trashëgiminë kulturore;

- 1.4. u sjellur në mënyrë profesionale ndaj shoqërisë, kolegëve, organeve të Odës, punëdhënësit dhe klientit, dhe

- 1.5. demonstruar kulturën e përgjithshme dhe profesionale, si dhe duke u përmbajtur nga çfarëdo ofendimi, dhune, shpifje apo sjellje negative, gjatë kryerjes së detyrave të tij, zhvillimit të punës në organet e Odës, komunikimit apo paraqitjeve publike.

Neni 6 **Rregullat themelore**

1. Ruajtja e shëndetit, sigurisë publike dhe mbrojtja e mjedisit janë rregullat bazë gjatë kryerjes së detyrave profesionale për inxhinierin.

2. Inxhinieri është i detyruar që:

- 2.1. në punën e tij t'i ketë parasysh kërkesat dhe nevojat e arsyeshme të qytetarëve dhe ato të publikut;

- 2.2. t'i trajtoj të gjithë në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim në çfarëdo baze, duke

respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në veprimtarinë e tij profesionale, ashtu edhe në jetën private;

2.3. të mbroj reputacionin dhe dinjitetin e profesionit;

2.4. të ofroj vetëm shërbime në kuadër të profesionit dhe drejtimit perkates akademik dhe mos të angazhohet në punë apo aktivitete që janë në kundërshtim me profesionin dhe reputacionin e inxhinierit;

2.5. në veprimtarinë e tij profesionale ta kryej me ndërgjegje, në pajtim me rregullat e profesionit, standardet dhe rregullat teknike si dhe legjislacionin në fuqi, por edhe të arriturat e shkencës dhe teknologjisë;

2.6. të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme profesionale dhe krijojë mundësi për zhvillim profesional të personave që kryejnë detyra nën mbikëqyrjen e tij;

2.7. të paguajë shumën e caktuar për anëtarësi në Odë, shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe taksat dhe tarifatat tjera të përcaktuara nga Oda;

2.8. të respektojë plotësisht të drejtat e autorit;

2.9. mos të ofroj shërbime profesionale për të cilat nuk është i autorizuar;

2.10. të mos publikojë informata dhe deklarata jo të sakta;

2.11. të shmangë konfliktin e interesit ashtu siç përkufizohet me ligjin përkatës në fuqi;

2.12. mos të konkurrojë në mënyrë jo të drejtë dhe të pandershme ndaj inxhinierëve tjerë;

2.13. të veprojë në përputhje të plotë me rregullat në fuqi të planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, si dhe zbatimin e kushteve dhe lejeve ndërtimore të përcaktuara me vendimet përkatëse të autoriteteve shtetërore;

2.14. me zgjidhjet e tij teknike, të kontribuoj në një mjedis të shëndetshëm dhe të këndshëm për të gjithë njerëzit, si në hapësirat e jashtme ashtu edhe ato të brendshme;

2.15. të refuzoj çfarëdo angazhimi ose privohet nga çdo veprim që mund të shkaktoj dëmtim të mjedisit, trashëgimisë kulturore apo shëndetit të njerëzve, dhe

2.16. njoftoj organet përkatëse për çdo shkelje të këtij Kodi të Etikës apo detyrave të inxhinierit apo profesionistit tjetër të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Sjellja në publik dhe marrëdhëniet biznesore

1. Sjellja e inxhinierit në publik duhet të jetë në përputhje me reputacionin dhe besimin në profesionin e inxhinierit.
2. Inxhinieri është i detyruar që të kujdeset për organizimin e punës, ekspertizën profesionale të punonjësve dhe kompanive që marrin pjesë në ekzekutimin e detyrave, përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme të tyre, për të përmbushur plotësisht detyrimet në mënyrë efektive dhe me kohë.
3. Inxhinieri refuzon punën për të cilën kushtet janë të tilla që pamundësojnë kryerjen e saj ose në rast që kjo punë është në kundërshtim me ligjet dhe dispozitat e këtij Kodi.
4. Inxhinieri nuk paraqitet ose prezanton vetën apo shërbimet profesionale në mënyrë të rrejshme apo mashtruese, e as nuk autorizon personat tjerë të bëjnë një gjë të tillë në emër të tij.
5. Me rastin e marrjes përsipër të shërbimit, inxhinieri detyrohet të lidh kontratë me shkrim me klientin, e cila përmban dispozita të qarta, për së paku:
 - 5.1. fushëveprimin dhe kohëzgjatjen e shërbimit/punës;
 - 5.2. shpërblimin/kompensimin për shërbimin e ofruar, si dhe mënyrën e pagesës;
 - 5.3. rrethanat për shkëputjen eventuale të kontratës dhe autoritetin për zgjidhjen e kontestit, dhe
 - 5.4. rregullat e veçanta për mbrojtjen e të drejtave të autorit.
6. Inxhinieri këshillon në mënyrë të pavarur dhe mbron plotësisht konfidencialitetin e klientit dhe palëve të treta të përfshira, si dhe përfaqëson interesat e klientit në përputhje me autorizimet dhe detyrimet ligjore.
7. Inxhinieri nuk zbulon asnjë informacion lidhur me klientin, çështjet biznesore apo transaksionet e tij, në mënyrë të pa autorizuar.
8. Inxhinieri nuk kushtëzon marrjen e shërbimeve apo punëve me shitje të pronave të paluajtshme, ndërmjetësimin e arritjes së marrëveshjes mes pronarëve të tokave për ndërtim dhe investitorëve, marrje të kredive, lejeve apo akteve tjera administrative, si dhe përfitimeve tjera jo ligjore.
9. Inxhinieri nuk ofron kurrfarë provizioni apo pagese për kryerjen e shërbimeve apo punëve që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij Kodi;

10. Inxhinieri nuk promovon, ndërmerr apo mbështet çfarëdo veprimi që mund të jetë shmangie tatimore apo vepër penale.

11. Inxhinieri nuk ofron e as nuk nënshkruan projektet të cilat nuk i ka përgatitur vet në kuadër të ushtrimit të profesionit apo që nuk ka qenë i përfshirë në udhëheqje, menaxhim dhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë.

12. Inxhinieri sigurohet që mos të shkel dispozitat nga ky nen as përmes punonjësve të tij, anëtarëve të familjes, personave apo ndërmjetësuesve tjerë të ndërlidhur.

Neni 8

Ushtrimi i detyrave tjera

1. Për deri sa nuk ndalohet nga legjislacioni në fuqi, Inxhinieri mund të kryej punë tjera të ndërlidhura me profesionin e inxhinierit.

2. Inxhinieri që mban detyrë publike apo është i punësuar në organet qeveritare ose lokale, nuk mund të përdor pozitën e tij për qëllime të kontraktimit të shërbimit ose punës, apo përfitimeve tjera për vete, anëtarët tjerë të Odës apo personat tjerë.

3. Inxhinieri nuk përdor njoftësitë, raportet dhe lidhjet me zyrtarët publik të përfshirë në procedurën administrative të kushteve dhe lejeve ndërtimore, si dhe veprimeve tjera administrative, për të ushtruar veprimtari në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat e këtij Kodi.

Neni 9

Marrëdhëniet e ndërsjella me kolegët

1. Çdo inxhinier respekton në mënyrë të plotë të drejtat e autorit dhe kështu nuk merr, përdor apo dëmton pronësinë intelektuale të personave tjerë, pa autorizim.

2. Inxhinieri detyrohet të ketë sjellje korrekte, të besueshme, ndihmuese dhe këshilluese me inxhinierët tjerë dhe anëtarët e Odës, si dhe nuk shpërndan asnjë informacion apo rrethanë të pavërtetë për ta.

3. Në rastet kur vlerëson punën dhe arritjet e një inxhinieri tjetër, inxhinieri është i detyruar që këtë ta bëjë në mënyrë objektive, si dhe pranojë në mënyrë konstruktive kritikën eventuale për punën e tij.

4. Çdo kritikë ndaj një projekti inxhinierik nga inxhinieri duhet të bëhet në mënyrë të arsyetuar dhe të bazohet në teorinë përkatëse. Kritika nuk duhet të bëhet me qëllime të këqija për dëmtimin apo diskreditimin e inxhinierit tjetër.

5. Inxhinieri nuk paraqet kritika negative ndaj një inxhinieri tjetër para klientit, si dhe nuk ndikon në një raport biznesor të krijuar në mes të klientit dhe inxhinierit tjetër, me qëllim të kontraktimit të shërbimeve apo punës së caktuar për vete apo një inxhinieri të tretë.

6. Në rast se inxhinieri kontaktohet nga klienti për kontraktim për shërbime apo punë në projekt ekzistues për të cilën tanimë ekziston marrëdhënia biznesore në mes të klientit dhe inxhinierit tjetër, ai është i detyruar që për këtë të njoftoj kolegun inxhinier i cili është ende në atë marrëdhënie biznesore. Inxhinieri pranon kontraktimin e shërbimit apo punës në këto raste vetëm nëse klienti ka kryer të gjitha detyrimet kontraktuale ndaj inxhinierit tjetër me të cilin ka qenë në marrëdhënie të biznesit.

7. Inxhinieri detyrohet të përmbush të gjitha detyrimet ndaj kolegëve inxhinierë dhe kolegëve të profesioneve tjera në kuadër të projekteve të përbashkëta apo ndaj atyre që veprojnë nën mbikëqyrjen e arkitektit apo inxhinierit.

8. Inxhinieri gjithashtu detyrohet të përmbush të gjitha përgjegjësitë ndaj punonjësit të tij, si dhe t'i mundësoj të tregoj aftësitë e tij dhe fitoj përvojën e punës përkatëse.

Neni 10

Kushtet financiare të ushtrimit të profesionit

1. Inxhinieri ka të drejtë në pagesë apo kompensim përkatës dhe të caktuar për punën dhe shpenzimet e tij gjatë ushtrimit të profesionit.

2. Inxhinieri nuk hyn në konkurrencë jolojale me inxhinierin tjetër përmes marrëveshjes e çmimeve të para caktuara, në kundërshtim me ligjin.

3. Inxhinieri nuk krijon marrëdhënie kontraktuale me çmime jo reale apo informata jo të verteta për çmimin e shërbimit apo kryerjes së punëve.

4. Çdo shërbim i projektimit që ofrohet së bashku me shërbimin e ndërtimit apo mbikëqyrjes, duhet të ndahet dhe bëhet i qartë në kontratën me klientin.

5. Çdo bashkëpunim, investim apo konkurrim i përbashkët me një inxhinier tjetër, duhet të bëhet përmes marrëveshjes me shkrim.

6. Në rast që inxhinieri merr pjesë në vlerësimin e një projekti konkurrues në kuadër të thirrjes publike, qoftë si anëtar i një komisioni apo në cilësinë e ekspertit të angazhuar, atëherë nuk ka të drejtë të përfshihet në asnjë mënyrë në realizimin e atij projekti në të ardhmen.

7. Inxhinieri sigurohet për udhëheqjen e kontabilitetit financiar të tij në përputhje me detyrimet ligjore.

Neni 11

Raporti me Odën

1. Inxhinieri dhe anëtar i Odës kanë përgjegjësi për mbrojtjen e reputacionit të Odës para klientit, institucioneve, organizatave tjera si dhe publikut.

2. Inxhinieri dhe anëtar i Odës përmbushin të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në Odë si dhe nga shërbimi në organin apo komisionin përkatës të Odës, përfshirë pjesëmarrjen në

mbledhjet e tyre.

3. Inxhinieri nuk përdor pozitën e tij në organin apo komisionin e Odës për të përfituar shërbime apo punë nga klienti, për vete apo inxhinierin tjetër.
4. Inxhinieri mundëson mbikëqyrjen përkatëse nga Oda ndaj punës së tij profesionale dhe ofron informatat dhe të dhënat përkatëse lidhur me këtë.

KAPITULLI III

EKZEKUTIMI I MASAVE DISIPLINORE DHE PARASHKRIMI

Neni 12

Ekzekutimi i masës disiplinore

1. Pas plotfuqishmërisë së një vendimi disiplinor ndaj inxhinierit, organi përkatës i Odës dhe Administrata e Odës ndërmerr menjëherë veprimet e nevojshme për zbatimin e masës disiplinore të shqiptuar.
2. Në rast të mos përmbushjes vullnetare nga inxhinieri të detyrimit të gjobës sipas vendimit të Komisionit Disiplinor, Administrata e Odës e dërgon vendimin për përmbarim në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
3. Gjoba e shqiptuar në procedurën disiplinore deponohet në Buxhetin e Odës, që menaxhohet në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës.
4. Vendimi për masën disiplinore të pezullimit të licencës së inxhinierit i dërgohet Komisionit Vlerësues i cili sipas detyrës zyrtare dhe në përputhje me rregulloren përkatëse pezullon licencën.

Neni 13

Parashkrimi

Ndaj inxhinierit të licencuar nuk mund të filloj procedurë disiplinore për detyrimet e përcaktuara me këtë Kod dhe Rregulloren për Procedurën Disiplinore, në qoftë se kanë kaluar dy (2) vite nga koha e kryerjes së shkeljes së lehtë të supozuar disiplinore, gjegjësisht pesë (5) vite nga koha e kryerjes së shkeljes së rëndë të supozuar disiplinore.

KAPITULLI IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca


Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës